

“BUKA” sh.a

NJOFTIM: Datë 03.04.2024

THIRRJE E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË BUKA SH.A.

BUKA sh.a, është një Shoqëri Aksionare Shqipëtare, e themeluar më datë 17.10.1995, me seli në adresën Rr. Kavajës, Tiranë. Bazuar në Statutin e Shoqërisë, BUKA sh.a, thërret Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (“Asambleja”), e cila do të mbledhet në selinë e Shoqërisë BUKA sh.a, në adresën, Rr. Kavajës, më datë 25.04.2024, në orën 10:00, sipas rendit të ditës të përcaktuar si më poshtë:

1. Dorëheqjen e Anëtarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Z.Gëzim Besholli (Administrator)
2. Emërimin e Anëtarit të ri të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Z.Agim Zika
3. Të ndryshme

Ftohen të gjithë Aksionarët e Shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre (konform kërkesave të ligjit të aplikuar), të marrin pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në vendin, datën dhe orën e cituar më lart. Përfaqësimi në Asamble do të bëhet konform dispozitave të nenit 140 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Statutit të Shoqërisë.

Për cdo pyetje, sqarim, informacion të mëtejshëm, sygjerim dhe/ose kërkesë në lidhje me rendin e ditës si dhe marrjen e dokumentacionit, mënyrën e thirrjes së kësaj mbledhje Asambleje, mënyrës dhe procedurave të përfaqësimit dhe votimit konform dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionarët e Shoqërisë (i) mund të paraqiten në selinë e shoqërisë cdo ditë (E Hënë- E Premte) nga ora 14:30 – 16:00; (ii) të shkruajnë në postën elektronike info@bukasha.com; (iii) të shkruajnë nëpërmjet postës së regjistruar në adresën e shoqërisë, duke përcaktuar qartë emrin dhe adresën e Aksionarit dërgues; apo (iv) të konsultojë faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë: www.buka-sha.com. Aksionarët apo përfaqësuesit e tyre duhet të kenë me vete një mjet identifikimi (kartë identitetit/pasaportë) dhe në rast përfaqësimi edhe prokurën e noteruar.

ADMINISTRATOR

Gëzim BESHOLLI